



Banka ProCredit sh.a, Rr. "Dritan Hoxha", Tirane, Shqiperi

No. Prot: PR-0042

Data: 16/04/2021

FTESE PER OFERTE

I nderuar Partner,

E themeluar ne vitin 1995, ne jemi pjese e grupit nderkombetar ProCredit. Ne jemi te mbikqyrur nga autoritete te larta te supervizimit gjerman, Bundesbank dhe BaFin qe sigurojne besueshmerine dhe qendrushmerine tone.

Qendrushmeria dhe besueshmeria jone, garantohet gjithashtu nga aksioneret tane. Ne jemi nje banke me nje kapital 100 % gjerman dhe aksioneri yne i vetem eshte ProCredit Holding, me qender ne Frankfurt, Gjermani, i cili ofron drejtim strategjik per grupin e bankave ProCredit.

I. Hyrje

Banka ProCredit eshte e interesuar te kontraktoj nje shoqeri te licensuar per realizimin e sherbimit te ruajtjes dhe sigurimit fizik me :

- ☐ punonjes sigurie te jashtem
- ☐ punonjes sigurie te brendshem
- ☐ operatore ne qendren e monitorimit te Bankes
- ☐ verifikim alarmi dhe patrullim me punonjes sigurie

per Zyrat Qendore (HO), Njesite e Biznesit (NjB), Zona 24/7-ATM dhe Arkiven qendrore ne Vore.

Per kete, Banka kerkon te bashkepunoje vetem me nje shoqeri, e cila duhet te permbush te gjitha kerkesat dhe kualifikimet e meposhtme per kryerjen e e ketij sherbimi.

Ju do te gjeni bashkangjitur kesaj ftese, Aneksin 1, ku paraqiten disa nga kerkesat e vecanta per te cilat Banka eshte e interesuar, te cilat **jane te detyrueshme** per tu realizuar.

Nderkohe, cmimet qe do te aplikohen do te jene ato qe shoqeria e perzgjedhur do te kete ofertuar ne Aneksin 2, qe do te jete pjese integrale e kontrates se bashkepunimit.

II. Objekti i Fteses per Oferte

Sherbim i ruajtjes dhe sigurimit fizik dhe per nevoja te ProCredit Bank sh.a.

Kjo Ftese per Propozim perbehet nga:

1.	Ftesa per oferte	6 faqe
2.	Aneksi Nr. 1	3 faqe
3.	Aneksi Nr. 2	3 faqe
4.	Aneksi Nr. 3	1 faqe
5.	Aneksi Nr. 4	3 faqe
6.	Aneksi Nr. 5	1 faqe
7.	Deklarata e gjendjes gjyqesore	1 faqe
8.	Letra Anti Korrupsion	2 faqe
9.	Pyetesori ILO	2 faqe
10.	Formulari ofertes	1 faqe

III. Oferta

Oferta juaj duhet të perbehet nga:

A. Oferta Ligjore, e cila paraqet *Kriteret e Pranimit/Kualifikimit dhe* duhet të perpilohet sipas kërkesave të renditura më poshtë.

1. Ekstrakti historik për të dhënat e subjektit leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, ku të ketë të pasqyruar vendet e ushtrimit të aktivitetit për të gjitha zonat që mbulon me shërbim.
2. Një dokument që verteton se subjekti juaj i ka plotësuar dhe shlyer detyrimet tatimore përfshirë dhe sigurimet shoqërore, leshuar nga Administrata Tatimore.
3. Deklaratë për gjendjen gjyqësore të shoqërisë sipas formatit bashkëngjitur kesaj ftese për ofertë.
4. License e Shoqërisë e Kategorisë I.3.A
5. Certifikatë e Drejtuesit Teknik (I.3 A), të leshuar nga Drejtoria e Përgjithëshme e Policisë së Shtetit dhe cv personale (edukim dhe eksperiencë pune).
6. Certifikatë për Titullar Subjekti (I.3 A), të leshuar nga Drejtoria e Përgjithëshme e Policisë së Shtetit dhe cv personale (edukim dhe eksperiencë pune).
7. Autorizim individual për përdorimin e frekuencave, leshuar nga AKEP, ku të përfshihen të gjitha zonat për të cilat kërkohet shërbimi (Tiranë, Durrës, Korçë, Shkoder, Fier).
8. Deklaratë e administratorit të shoqërisë për listën e mjeteve nderlidhëse, dedektoreve, apo paisjeve speciale/armatimeve të ngjashme.
9. Deklaratë e Administratorit të Shoqërisë për punonjësit e shërbimit sigurisë fizike (Kategoria I.3 A) (emer, mbiemer, datelindja,...etj, për Qarkun Tiranë, Durrës, Korçë, Shkoder, Fier, ku Banka ka Njësiti e Biznesit.
10. Vertetimin e leshuar nga Drejtoria e Policisë së Qarkut (akt miratimi) (Tiranë, Durrës, Korçë, Shkoder, Fier), për disponimin e sallës operative, sipas afatëve dhe parashikimeve ligjore.
11. Vertetim performancë për periudhën nga data 01.01.2020 e në vazhdim, leshuar në 6 mujorin e fundit nga Drejtoria e Policisë të Qarqeve Tiranë, Durrës, Korçë, Shkoder, Fier ku të shprehet për kapacitetet e shoqërisë (qendrat e kontrollit, objekte në ruajtje me punonjës shërbimi, objekte në ruajtje me verifikim alarmi, punonjës shërbimi, grupe të gatshme, armatim, mjete speciale, automjete, numrin e shkeljeve, masa administrative gjatë viteve të fundit, shlyerjen e detyrimeve).

Shënim i rëndësishëm: Kriteret e përcaktuara në pikën 1-11 janë **kritere skualifikuese**.

Dokumentacioni i kërkuar në Kriteret e Pranimit/Kualifikimi në pikat 1 dhe 2, duhet të vertetohet përmes dokumentave të leshuar jo më parë se tre muaj nga data e fundit e dorezimit të ofertes. Dokumentat e mësipërme mund të paraqiten origjinal/ të noterizuar ose kopje të dokumentave origjinale. Ofertuesit të shpallur fitues do të kërkohet ky dokumentacion në origjinal ose fotokopje të noterizuar.

B. Oferta teknike (Kriteret e vlerësimit të cilësive)

B.1 Kriteret skualifikuese

Shoqëria e përzgjedhur fituese në mënyrë të detyrueshme duhet të plotësojë kriteret si më poshtë:

- a. Të ketë shtrirje dhe të mbulojë me salla monitorimi/qendra kontrolli me regjim 24/7, me numër punonjësish sipas përcaktimeve ligjore në fuqi, të gjitha lokacionet ku Banka ushtron aktivitetin e saj (Tiranë, Durrës, Korçë, Shkoder dhe Fier).
- b. Të ketë të përfshira në flotën e shërbimit, në Qarkun Tiranë jo më pak se 3 automjete dhe 3 motora, në Qarkun Durrës jo më pak se 1 automjet/motor, në Qarkun Korçë jo më pak se 1 automjet/motor, në Qarkun Shkoder jo më pak se 1 automjet / motor dhe në Qarkun Fier jo më pak se 1 automjet /motor.
- c. Të ketë grupe të gatshme për të mbuluar shërbimin 24/7, sipas përcaktimeve ligjore, për çdo qark ku Banka ushtron aktivitetin (Tiranë, Durrës, Korçë, Shkoder, Fier).
- d. Eksperiencë në treg minimalisht 3 vjet.
- e. Eksperiencë në marrëdhënie me institucione të tjera financiare, në 3 vitet e fundit.
- f. Të përcaktojë një person që do të shërbejë si "menaxher i kontratës", i cili në bashkëpunim të ngushtë me punonjësit përgjegjës të Bankës ProCredit, do të kordinojë procesin për realizimin e kushteve të kontratës.
- g. Punonjësit e shërbimit të sigurisë preferohen të jenë të moshës deri 45 vjeç.

B.2 Kriteria të vlerësimit me pike.

1. Kapaciteti teknik profesional dhe eksperiencia të ngjashme

Shoqëria juaj, duhet të provojë se disponon aftësitë teknike dhe profesionale për realizimin e objektit të kërkuar, në këtë proces tenderimi përmes dokumentacionit si më poshtë:

- Vertetim performance për periudhën nga data 01.01.2020 e në vazhdim, leshuar në 6 mujorin e fundit nga Drejtoritë e Policive të Qarqeve Tirane, Durrës, Korçë, Shkoder, Fier ku të shprehet për kapacitetet e shoqërisë (qendrat e kontrollit, objekte në ruajtje me punonjës shtetëror, objekte në ruajtje me verifikim alarmi, punonjës shtetëror, grupe të gatshme, armatim, mjete speciale, automjete, numrin e shkeljeve, masa administrative gjatë viteve të fundit, shlyerjen e detyrimeve).
- Referenca nga institucione në të cilat shoqëria ka kryer/kryen shtetërorin me roje sigurie fizike. Në referencë të jete cituar numri, data e kontratës si dhe komente për cilësinë e saj.
- Listë e subjekteve/institucioneve financiare në të cilat shoqëria ka kryer/kryen shtetërorin me punonjës sigurie apo verifikim alarmesh për 3 vitet e fundit duke përfshirë edhe periudhën e bashkëpunimit. Lista të ketë edhe numra kontakti telefoni në mënyrë që banka të kontaktojë subjektin ku ju keni ofruar/ofroni shtetërorin. (referuar Aneks Nr. 3 bashkëngjitur)
- Vertetim për pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, për 3 mujorin e fundit. Vertetimi të shoqërohet me listë pagesat përkatëse.
- Shoqëria juaj duhet të dërgojë çdo dokument që verteton infrastrukturën dhe burimet njerezore në dispozicion të shoqërisë për këtë shtetërorin si:
 - Listë për numrin e flotës së mjeteve (automjet, motor) që përdoret për këtë shtetërorin të ndara sipas qarqeve ku Banka ushtron aktivitetin (Tirane, Durrës, Korçë, Shkoder, Fier), shoqëruar me kopje të certifikatave të leshuara për këto mjete.
 - Listë për punonjësit e shtetërorin të sigurisë fizike (Kategoria I.3 A) (emer, mbiemer, datëlindja, detyra që kryhen..etj.) të ndara sipas qarkut ku Banka ushtron aktivitetin (Tirane, Durrës, Korçë, Shkoder, Fier). Listë për punonjësit e shtetërorin patrullë/grup i gatshëm të ndare sipas qarkut ku Banka ushtron aktivitetin (Tirane, Durrës, Korçë, Shkoder, Fier).
- Certifikatat e standarteve të sigurisë të vlefshme (sistemi i menaxhimit të cilësive, sistemi i menaxhimit të mjedisit, sistemi i menaxhimit të sigurisë në punë) leshuar në emër të kompanisë, në përputhje me objektin e ftesës për ofertë:
 - UNI — EN — ISO 9001 : për sistemin e menaxhimit të cilësive,
 - UNI — EN — ISO 14001 : për sistemin e menaxhimit të mjedisit,
 - UNI — EN — ISO 45001 : për sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë
- Certifikata trajnimit të ndryshme.
- Shoqëria duhet të paraqesë/disponojë çertifikatë/a leshuar nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK).

2. Aftësitë e realizimit të shtetërorin të verifikimit të alarmeve në objektet e Bankës:

Lutemi të specifikoni mënyrën dhe kohën e verifikimit dhe reagimit në rast alarmi për secilin objekt të Bankës sipas aneksit përkatës. Mënyra e reagimit dhe verifikimit duhet të jete detajuar dhe të përfshijë mjetet dhe punonjësit e shtetërorin që angazhohen për secilin objekt të Bankës.

Nr.	Destinacioni	Koha e reagimit në intervalet e kohës	
		07 : 00 - 22 : 00	22 : 00 - 07 : 00
1	Qyteti i Tiranës		
2	Arkiva Vore - Tirane		
3	Qyteti i Shkodrës		

4	Qyteti i Durrësit		
5	Qyteti i Korçës		
6	Qyteti i Fierit		

Shoqëria ofertuese mund të bashkangjijë edhe dokumente shtesë, të cilat mendojnë se do të qartësojnë më mirë ofertën e tyre.

Bashkëngjitur me këtë Ftesë për Ofertë do të gjeni Letren Antikorrupsion, Deklaratën mbi Gjendjen Gjyqësore dhe Pyetësin ILO, të cilat duhet të firmosen nga përfaqësuesi i subjektit tuaj dhe duhet të shoqërojnë ofertën tekniko-ligjore.

C. Oferta Ekonomike

Oferta ekonomike duhet t'u përmbahet kërkesave të Aneksit Nr. 1, bashkëngjitur kësaj ftese për ofertë. Çmimet e ofruara duhet të përfshijnë TVSH-në dhe monedha e kuotuar duhet të jete në Leke.

Formulari i Ofertes: Bashkëngjitur me ftesën për ofertë është Formulari i Ofertes i cili duhet të firmoset/vulohet nga shoqëria juaj dhe të dërgohet së bashku me ofertën ekonomike.

IV. Dorezimi i Ofertes

Oferta juaj duhet të jete e ndarë në **dy zarfa të ndryshme. Dokumentacioni ligjor dhe teknik duhet të jete në një zarf dhe oferta ekonomike në një zarf tjetër.**

Të dyja keto zarfa të cilat duhet të shenojnë qartë se çfarë përmbajnë. Zarfat duhet të jete të vulosur nga shoqëria në pjesën e ngjitjes së tyre. Ata duhet të kete të shkruar qartë: **Sherbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike për nevojat e ProCredit Bank sh.a., dhe Emrin e Shoqërisë** që e dërgon. Zarfat duhet të protokollohen pranë recepsionit të Zyrrave Qendrore të PCB-së dhe Shoqëria duhet të sigurohet që kjo ofertë është protokolluar. Për të shmangur çdo paqartësi, kërkojmë që përfaqësuesi i shoqërisë të mos largohet nga Zyrrat Qendrore të PCB-së pa marrë numrat e protokollit të ofertes. **Në total duhet të jete dy numra protokoll.**

Në rast se oferta juaj dorezohet e hapur, me e-mail, fax ose në ndonjë mënyrë tjetër nga ajo që kërkuar më lart, oferta nuk do të konsiderohet e vlefshme.

Oferta juaj, në një zarf të mbyllur dhe të vulosur, në formatin e kërkuar do të adresohet dhe paraqitet në:

Ref: 20210205

- Sherbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike për nevojat e ProCredit Bank sh.a.

**ProCredit Bank sh.a.
Rr. Dritan Hoxha
Lapraçe, Tiranë**

V. Vlerësimi i Ofertes

Shoqëritë pjesëmarrëse do të vlerësohen sipas kritereve të mëposhtme:

Kriteret e Vlerësimit	Pesha specifike (%)
Termet financiare (oferta financiare)	60 %
Termet Teknike	40 %

Kriteret teknike (te vleresuara me pike) ¹	Pesha specifike per secilin kriter teknik (%)
1. Eksperienca e pergjithshme e shoqerise (Vleresimi do te behet referuar dokumentacionit te dorezuar/te kerkuar ne Piken B2)	30
2. Vleresimi i performances se shoqerise (Vleresimi do te behet referuar dokumentacionit te dorezuar/te kerkuar ne Piken B2)	30
3. Kapaciteti i shoqerise per burimet njerezore, mjetet ne dispozicion dhe infrastrukturen (Vleresimi do te behet referuar dokumentacionit te dorezuar/te kerkuar ne Piken B2)	35
4. Certifikate e sigurise a) UNI — EN — ISO 9001 : per sitemin i menaxhimit te cilesise, b) UNI — EN — ISO 14001 : per sistemin e menaxhimit te mjedisit, c) UNI — EN — ISO 45001 : per sistemin i menaxhimit te sigurise ne pune. d) Certifikate/a leshuar nga Drejtoria e Sigurimit te Informacionit te Klasifikuar (DSIK), e) Certifikata te tjera (Vleresimi do te behet referuar dokumentacionit te dorezuar te kerkuar ne Piken "B2", nenpika 1.)	5

Sqarim:

- Vetem shoqerite qe do te dorezojne te gjitha dokumentacionin e kerkuar ne piken A "Oferta Teknike-Ligjore" si dhe ne piken B1, do te kualifikohen per ne fazen tjeter te procesit.
- Pas shqyrtimit te ofertes tekniko – ligjore, Banka procedon me vleresimin e ofertes financiare. Do te procedohet me hapjen e Ofertave Ekonomike te shoqerive te cilat do te kualifikohen teknikisht dhe ligjorisht. Oferta financiare per shoqerite te cilat nuk kualifikohen ne fazen e pare nuk do te hapet.
- Banka do te njoftoje me shkrim, nepermjet email nese jeni perzgjedhur ose jo fitues.
- Shoqeria qe do te grumbulloje me shume pike ne perfundim te vleresimit (teknik dhe financiar), do te perzgjidhet nga Banka per te bashkepunuar per sherbimet e kerkuara objekt te kesaj ftese per oferte.
- Ne perfundim te ketij procesi, Banka do te lidhe nje marreveshje bashkepunimi me shoqerine e perzgjedhur fituese me afat bashkepunimi 3 vjet.

VI. Afati i dorezimit

Afati i fundit per dorezimin e ofertave ne Banke, ne adresen e mesiperme eshte **date 4 Maj 2021, ora 16.00.**

Per cdo pyetje ju lutem mos hezitoni t'i adresoni ne: info_procurement@procredit-group.com.

¹ Tabela e detajuar e vleresimit gjendet ne Aneksin Nr. 6

Per cdo ankese ne lidhje me vendimin per procesin e prokurimit ju lutemi mos hezitoni t'i adresoni ne:
albankesaprokurime@procredit-group.com

Ju lutem percaktoni ne oferten tuaj menyren e marrjes se kesaj Ftese per Oferte duke vendosur nje kryq per nje nga menytrat e meposhtme:

- a) derguar me email nga banka _____
- b) nepermjet internetit _____
- c) eshte terhequr prane bankes _____
- d) nga shoqeri te tjera _____

Sinqerisht,

ProCredit Bank sh.a



Pershkrim i pergjithshem i sherbimit dhe specifikat teknike

Shoqeria organizon me punonjesit e saj, kryerjen e sherbimit te jashtem, te brendshem, sherbim ne qendren operatore, verifikimin e sinjaleve te alarmit dhe patrullimin ne rast nevojave ne te gjitha njesite e biznesit, Zonat 24/7, ATM-te, objektet e bankes ne te gjitha vendin, duke zbatuar ligjet dhe aktet nenligjore ne fuqi per kete sherbim.

1. Kryerja e sherbimit te sigurise me punonjes te brendshem.

Punonjes i sherbimit te sigurise se brendshme, do te ruaje fizikisht nga veprat keqberese, kriminale njesine e biznesit dhe objektete e bankes, ne keto drejtime kryesore ;

- parandalimi dhe nderhyrja per bllokimin e tentativave per grabitje, vjedhje, te vlerave monetare dhe materiale brenda ambjenteve te objektit,
- parandalimi dhe nderhyrja per parandalimin dhe bllokimin e tentativave per demtimin e punonjesve dhe klienteve,
- mbajtja dhe sigurimi i rendit dhe qetesise brenda ambjenteve,
- nderhyrjen ne rast zjarri, permbytje dhe fatkeqesi te tjera natyrore.
- nderhyrjen per mbajtjen te paprekur te zones/skenes se krimit gjate nje ngjarje, situatë kriminale.
- bashkepunimi dhe menaxhimi per situatat e mundshme emergjente.

Punonjesi i sigurise eshte prezent kur hapet objekti dhe largohet prej tij kur objekti mbyllet, largohen punonjesit dhe aktivizohet sistemi i alarmit.

Gjithashtu, sipas nevojave te bankes si dhe sherbimet 24/7, ai qendron dhe paraqitet ne sherbim edhe jashte orarit te punes si dhe ne ditet e pushimit e festave zyrtare.

2. Uniforma e sherbimit (siguria e brendshme).Punonjesi i sherbimit te sigurise se brendshme, kryen sherbimin me uniforme civile ngjyre blu , kostum (xhakete, pantallona) , kemishe te bardhe, kravate, , si dhe mban shenjat (logo) dalluese te kompanise (dokument identifikimi), sipas percaktimeve te ligjit nr 75/2014 per "Sherbimin Privat te Sigurise Fizike" dhe akteve te tjera nenligjore..

Punonjesit paisen me uniforme nga shoqeria.

3.Ruajtja me punonjes te sherbimit te jashtem

Punonjesi i sherbimit te sigurise se jashtme, do te ruaje fizikisht nga veprat keqberese, kriminale njesine e biznesit te bankes, objektete e bankes, ne keto drejtime kryesore;

- parandalimin dhe bllokimin e hyrjes ne objekt te grabitesve;
- parandalimin e veprimeve qe demtojne punonjesit dhe klientet ne banke,
- parandalimin e demtimit te vlerave materiale te bankes,
- parandalimin dhe pengimin e veprimeve qe demtojne ATM-ne e bankes,
- nderhyrjen ne rast zjarri, permbytje dhe fatkeqesi te tjera natyrore.
- bashkepunimi dhe menaxhimi per situatat e mundshme emergjente

Punonjesi i sigurise eshte prezent ne oraret sipas sherbimeve te kerkuara nga banka

4. Uniforma e sherbimit (siguria e jashtme).

Punonjesi i sherbimit te sigurise se jashtme, kryen sherbimin me uniforme sherbimi baze ose operacionale si dhe mban shenjat dalluese te SHPSF-se sipas percaktimeve te ligjit nr 75/2014 per "Sherbimin Privat te Sigurise Fizike" dhe akteve te tjera nenligjore.

Punonjesi i sigurise se jashtme, duhet te jete i paisur nga shoqeria me arme brezi neutropralizuese.
Punonjesit paisen me uniforme nga Sipermarresi.

Pervec sa me siper, banka mund te kerkoje sherbime me punonjes te brendshem apo te jashtem, ne varesi te nevojave qe mund te kete ne objektete e bankes.

5. Verifikimi i sinjaleve te alarmit

Shoqeria do te verifikojë sinjalet e alarmit te shkatuara nga sistemet e mbrojtjes dhe sigurise elektronike te instaluar ne Drejtorine e Pergjithshme, njesite e biznesit, arkiven Vore, objekte te bankes dhe ATM-te e saj te shperndara ne te gjithë territorin e vendit. Sinjalet e alarmit mund te shkatohen nga :

- alarme per hyrje te pautorizuara,
- alarme per grabitje
- alarme per rrezik zjarri/ritje te mperatures ne server,
- alarme per veprime abuzive me ATM-te,
- alarme per demtim thyerje te objektit,
- alarme per defekte teknike/shkeputje te energjise elektrike...etj.

Verifikimi i alarmeve, duhet te kryhet nga punonjes te sigurise te kompanise, (grupe te gatshme, verifikues alarmi).

6. Sherbimi Patrulle

Shoqeria mund te organizojë sherbim patrulle ne rast se kerkohet nga banka, me mjet te saj, per te kontrolluar objektet dhe te gjitha ATM-te e bankes. Patrullimi do te kryhet sipas percaktimeve ne aneksin perkates..

Punonjesit e Sherbimit Patrulle, pas paraqitjes ne objekt dhe ATM-te e Bankes, kryejne keto detyra:

6.1 Gjate ptrullimit te objekteve te bankes ne rast nevojë (HO, njesi biznesi, zona 24/7) ;

- Kontrollone gjendjen fizike dhe vizuale te objektit ne gjithë perimetrin e tij.
- Kontrollone gjendjen fizike te paisjeve te sherbimit ne zonen 24/7.
- Kontrollone vendosjen e pajisjeve kopjuese ne paisjet e sherbimit ne zonen 24/7.
- Evidentojne cdo element apo shkak qe mund te cenoje sigurine e objektit
- Njoftojne qendren e sigurise ne banke dhe kompanise per cdo rast te verifikimit te situatave te dyshimta ne objekt.

6.2 Gjate ptrullimit te ATM-ve off site.

- Kontrollone gjendjen fizike te ATM-ve off-site ne te gjithë perimetrin ku eshte instaluar
- Kontrollone vendosjen e pajisjeve kopjuese ne ATM-te off-site.
- Njoftojne qendren e sigurise ne banke dhe kompanise per cdo rast te verifikimit te situatave te dyshimta ne ATM.

6.3 Patrullimi kryhet sipas frekuences se kerkuar nga banka dhe raportohet dhe evidentohet gjendja e objekteve per kontrollet e kryera gjate periudhes 24 oreshe.

Shoqeria mban regjister te vecante ku evidenton te gjitha sherbimet e patrulles, si dhe sherbimet e verifikimit te alarmeve ne te gjitha objektet dhe ATM-te e bankes. Regjistri mbahet per te gjithë periudhen e marredhenieve kontraktore dhe i jepet bankes ne te gjitha rastet qe kerkohet prej saj.

7. Salla Operative / Qendra e Sigurise.

Shoqeria ka salla te perqendruara operative te paisur me teniken e nevojshme elektronike ne te gjitha qarqet ku banka ka njesite e biznesit dhe objektet e saj, ne zbatim te ligjit nr 75/2014 per "Sherbimin Privat te Sigurise Fizike" dhe akteve te tjera nenligjore, per raportimet dhe marrjen me GSM (SMS)/thirrje, te sinjaleve te alarmit nga te gjitha Njesite e Biznesit/objektet dhe ATM-te e bankes si dhe per drejtimin dhe kryerjen e ptrullimit per verifikimin e sinjave nepermjet grupeve te gatshme, verifikuesit te sinjaleve te alarmit.

Shoqeria kryen sherbim me punonjes sigurie "operatore" ne te gjitha ditet e javes 24/7, dhe pergjegjes, edhe ne qendren e sigurise se bankes. Keta operatore duhet te jene te trajnuar nga shoqeria qe te kryejne sherbimin "operator" sipas kushteve te ligjit nr 75/2014 per "Sherbimin Privat te Sigurise Fizike" dhe akteve te tjera nenligjore .

Teknika dhe paisjet informatike ne kete qender sigurie, jane prone e bankes.

8. Sherbim shoqerim personeli me truproje dhe transporti i grupit te gatshem.

Shoqeria do te ofroje sipas kerkesave te bankes, sherbim me truproje si dhe sherbim e transport me grup te gatshem ne Tirane e jashte saj, ne te gjitha territorin e vendit.

9. Sherbim ne receptionin e bankes

Sipermarresi kryen sherbim me punonjes sigurie te brendshem, ne te gjitha ditet e javes 24/7, ne receptionin e bankes ne Drejtorine e Pergjithshme.

Sipermarresi kryen sherbim me punonjes sigurie te jashtem, ne te gjitha ditet e javes 24/7, ne objektin e arkives qendrore te bankes ne Vore.

10. Banka, kerkon sherbim me rreth 7 punonjes te jashtem sigurie, rreth 10 punonjes te brendshem sigurie, si dhe afersisht 10 operatore.

Aneksi Nr, 2

Oferta e ekonomike e cila duhet te plotesohet sipas kerkesave te meposhtme:

Pershkrimi i sherbimit	Cmimi / leke (Tvsh e perfshire)	Shenime
1. Sherbim me punonjes te brendshem sigurie, per 8 (tete) ore pune, (Hene-e Premte). Puna fillon/mbaron sipas orarit te percaktuar nga banka		Cmimi duhet te perfshije sherbimin e kryer nga nje (1) punonjes sigurie per afatin kohor 1 muaj .
2. Sherbim me punonjes te brendshem sigurie, per 8 (tete) ore pune, qe eshte e nevojshme te punoje me regjim gjate 24 oreve.		Cmimi duhet te perfshije sherbimin e kryer nga nje (1) punonjes sigurie i brendshem gjate periudhes 24 orareshe ne 7 dite te javes per afatin kohor 1 muaj , duke marre parasysh percaktimet ligjore ne fuqi. *
3. Sherbim me punonjes te jashtem sigurie, per 8 (tete) ore pune, (Hene-e Premte). Puna fillon/mbaron sipas orarit te percaktuar nga banka		Cmimi duhet te perfshije sherbimin e kryer nga nje (1) punonjes sigurie per afatin kohor 1 muaj .
4. Sherbim me punonjes te jashtem sigurie, per 8 (tete) ore pune, qe eshte e nevojshme te punoje me regjim gjate 24 oreve.		Cmimi duhet te perfshije sherbimin e kryer nga nje (1) punonjes sigurie i jashtem gjate periudhes 24 orareshe ne 7 dite te javes per afatin kohor 1 muaj , duke marre parasysh percaktimet ligjore ne fuqi. *
5. Sherbim me punonjes te brendshem ose te jashtem sigurie. Cmimi duhet te perfshije sherbimin e kryer nga nje (1) punonjes gjate diteve te javes. Cmimi/Ore Sherbimi.		Cmimi duhet te perfshije sherbimin e kryer nga nje (1) punonjes sigurie i brendshem ose/i jashtem, gjate 7 diteve te javes ne 24 ore. Cmimi/Ore Sherbimi .
6. Sherbim sigurie me grup te gatshem me automjet/motor te kompanise.		Cmimi duhet te perfshije sherbimin e kryer nga nje (1) grup i gatshem cdo ore sherbimi te kryer, gjate 7 diteve te javes ne 24 ore. Cmim/Ore Sherbimi .
7. Sherbim i verifikimi te sinjaleve te alarmit te gjeneruara nga sistemet e sigurise elektronike te instaluar ne objektetet dhe paisjet e Bankes, apo verifikime per problematika/situata te ndryshme		Cmimi perfshin vajtjen dhe verifikimin e alarmit/problematikes ne objekt apo paisje. Cmimi/rast verifikimi.
8. Sherbimi Patrulle per objektet e bankes.		Cmimi duhet te perfshije sherbimin e patrullimit nga grup i gatshem cdo 4 (kater) ore, ne cdo 24 ore ne 7 dite te javes ne objekt te bankes (HO, Njesi Biznesi, Zone 24/7) te Bankes. Cmim/Muaj Sherbimi .
9. Sherbimi Patrulle per objektet e bankes.		Cmimi duhet te perfshije sherbimin e patrullimit nga grup i gatshem cdo 8 (tete) ore, ne cdo 24 ore ne 7 dite te javes ne objekt te bankes (HO, Njesi Biznesi, Zone 24/7) te Bankes. Cmim/Muaj Sherbimi
10. Sherbimi Patrulle per objektet e bankes.		Cmimi duhet te perfshije sherbimin e patrullimit nga grup i gatshem cdo 12 (dymbedhete) ore, ne cdo 24 ore ne 7 dite te javes ne objekt te bankes (HO, Njesi Biznesi, Zone 24/7) te Bankes. Cmim/Muaj Sherbimi
11. Sherbimi Patrulle per ATM off-site.		Cmimi perfshin sherbimin e patrullimit nga grup i gatshem cdo 4 (kater) ore, ne cdo 24 ore ne 7 dite te javes ne ATM off-site te Bankes. Cmim/Muaj Sherbimi
12. Sherbimi Patrulle per ATM off-site.		Cmimi perfshin sherbimin e patrullimit nga grup i gatshem cdo cdo 8 (tete) ore, ne cdo 24 ore ne 7 dite te javes ne ATM off-site te Bankes. Cmim/Muaj Sherbimi
13. Sherbimi Patrulle per ATM off-site.		Cmimi perfshin sherbimin e patrullimit nga grup i gatshem cdo 12 (dymbedhete) ore, ne cdo 24 ore ne 7 dite te javes ne ATM off-site te Bankes. Cmim/Muaj Sherbimi
14. "Sherbim shoqerim personeli" me truproje me mjete te bankes		Cmimi duhet te perfshije sherbimin e kryer nga nje (1) punonjes sigurie per cdo Ore Sherbimi te kryer. Cmim/Ore Sherbimi
15. "Sherbim shoqerim personeli" me truproje me mjete te kompanise		Cmimi duhet te perfshije sherbimin e kryer nga nje (1) punonjes sigurie per cdo Ore Sherbimi te kryer. Cmim/Ore Sherbimi
16. Sherbim me grupin e gatshem me automjetet te kompanise jashte qytetit te Tiranes		Sherbimi duhet te parashikojte nje automjet dhe (1) grup i gatshem (jo me pak se dy punonjes sigurie) ** Cmimi duhet te shprehet ne leke/kilometer .
17. Sherbim sigurie me nje punonjes me automjetin/motorin e grupit te gatshem te shoqerise.		Cmimi duhet te perfshije sherbimin e kryer nga nje punonjes sigurie per cdo ore sherbimi. Cmim/Ore Sherbimi
18. Sherbim ne qendren operatore		Cmimi duhet te perfshije sherbimin e kryer nga nje operator per afatin kohor 1 muaj , duke marre parasysh percaktimet ligjore ne fuqi. ***

*** Ne piken 2 dhe 4 behet fjale per sherbime me sistem 24 ore/7 dite te javes**

**** Vlera totale e sherbimit do te perlllogaritet duke mbledhur koston e transportit me vleren per oret e gendrimit (Pika 6).**

***** Sherbimi ne qendren operatore me sistemin 24 ore/7 dite ne dy poste pune.**

Sqarim:

- Cmimet e ofruara duhet te perfshijne te gjitha detyrimet tatimore. Monedha e kuotuar duhet te jete ne Leke.
- Vlefshmeria e ofertes duhet te jete gjashte muaj (180 dite) nga data e dorezimit.
- Propozimi juaj financiar eshte e nevojshme te vije i detajuar sipas kostove qe perbejne totalin per cdo ze. Banka nuk do te pranoje oferta te cilat bien ndesh me legjislacionin ne fuqi per pagen minimale te ketij sherbimi ku te jene te perfshira te gjitha detyrimet sipas kodit te punes.
- Ofertuesit duhet te garantojne realizimin e dhenjes se sherbimeve te siperpermendura sipas kushteve te ofertuara
- Shoqeria fituese duhet te ruaje ne konfidence dhe duhet te mos shpalos asnje informate qe i zbulohet para dhe gjate kohezgjatjes se kontrates e deri ne kohe te pakufizuar te palet e tjera.
- Ofertuesi duhet te jete i gatshem per ofrimin e sherbimeve menjehere pas lajmerimit nga banka se oferta e tyre ka qene e suksesshme.
- Asnje shpenzim qe shoqerite ofertuese bejne gjate pergatitjes dhe dorezimit te kuotimit te cmimit nuk do te kompensohet.
- Banka ProCredit ka te drejte te anuloje tenderin dhe/ose ndryshoje karakteristikat e tenderit dhe ti ftoje pjesemarresit per te sjelle serish ofertat e tyre

Aneksi Nr. 3

Referenca per kontrata te ngjashme per periudhen mars 2018- e ne vazhdim

Tabela 3: Referenca te ngjashme

	Klienti	Data e fillimit te kontrates	Data e perfundimit te kontrates	Qyteti ku eshte ofruar sherbimi	Personi kontaktit/pozicioni	Numri i telefonit te personit te kontaktit
1						
2						
3						
4						
5						
6						
7						
8						
9						
10						
11						
Etj			Shenim: Shembujt e mesiperme jane dhene per te treguar si duhet te plotesohet tabela e referencave			

Aneksi Nr. 4:

Kushtet paraprake te kontrates

Banka ruan te drejten e ndryshimit te ketyre kushteve paraprake:

1. Nese gjate kohes qe kjo kontrate eshte ne fuqi, rrjeti i Njesive te Biznesit te Bankes, ose per ndryshime organizimi te brendshem, duke bere te nevojshme sherbime shtese te sherbimit te ruajtjes dhe sigurimit fizik, Sipërmarresi eshte i detyruar te ofrojë sherbimet e sigurise fiziket me punonjes sherbimi te brendshem, te jashtem, operatore, me cmimet e percaktuara paraprakisht ne aneksin perkates te kontrates.
2. Ne rast se gjate kohezgjatjes se kesaj kontrate Banka vendos te mbyll aktivitetin ne ndonje , Njesi Biznesi, reduktimin e numrit te ATM-ve off site, banka ka te drejte te kerkoje nderprerjen e ketij sherbimi/patrullimi duke njoftuar palen tjeter te pakten 10 dite perpara nderprerjes se sherbimit.
3. Shoqeria i paraqet listen e punonjesve te sherbimit qe do te punojne per zbatimin e kontrates, te specifikuar ; punonjes te sigurise se jashtme, punonjes te sigurise se brendshme, operatore.

Detyrime te shoqerise

1. Sipërmarresi, per te permbushur objektin e kesaj kontrate, duhet te jete i paisur me Licensat ne nenkategorine I.3 A " Sigurimi Fizik i objekteve shtetore e private, si dhe veprimtarive social-kulturore, sportive, fetare e politike" si dhe autorizimet e nevojshme qe e mundesojne SHPSF-ne te kryej sherbimin e ofruar Bankes sipas ligjeve, udhezimeve dhe rregullore ne fuqi
2. Drejtuesi teknik i shoqerise, duhet te ushtroje me kompetence dhe pergjegjshmeri detyrimet e percaktuara ne nenin 25 (Drejtuesi Teknik) dhe 26 (Pergjegjesite e drejtuesit Teknik) si dhe te ushtroje kontroll te vazhdueshem per ushtimin e pergjegjesve te Punonjesit te sherbimit te percaktuar ne nenin 27 te ligjit nr 75/2014 per "Sherbimin Privat te Sigurise Fizike".
3. Drejtuesi Teknik i SHPSF-se perpilon plan - dislokimin per cdo objekt se bashku me skemat e ruajtjes dhe plane te vecanta ruajtje per situata emergjente per cdo objekt bankar.
4. Sipërmarresi, duhet te kete qendrer kontrolli ne cdo njesi administrative qe ushtron veprimtarine banka, sipas percaktimeve ne ligjin nr 75/2014 per "Sherbimin Privat te Sigurise Fizike" dhe udhezimit te ministrit te Puneve te Brendshme nr. 175, date 1.04.2015
5. SHPSF vendos ne banke punonjes sherbimi te paisur me certifikatat perkatese dhe te trajnuar, ne zbatim te ligjit.
6. Sipërmarresi, duhet te njoftoje Banken menjehere dhe me e-mail brenda 24 oresh, per cdo ndryshim te personelit te sherbimit si dhe per cdo rast konstatimi te veprimeve qe cenojne sigurine e jetes se punonjesve te bankes, klienteve ne ambientet e brendshme si dhe cenim te pasurise e saj.
7. Sipërmarresi, duhet te informoje Banken menjehere dhe brenda 24 oresh me e-mail per cdo rast shkelje te masave te sigurise nga punonjesit e saj.
8. Sipërmarresi, duhet te garantoje nderlidhjen e punonjesve te sherbimit te brendshem dhe te jashtem me qendren e sigurise se tij.Sipërmarresi, duhet te kryejë sherbimin sipas rregullores se perbashket te sherbimit bashkangjitur kontrates.
9. Sipërmarresi largon dhe/ose zevendeson menjehere, punonjesit e sherbimit ne rast se kjo kerkohet nga banka.
10. Te garantoje nderlidhjen e punonjesve te sherbimit te sigurise, te jashtem, te brendshem, grupe te gatshme, grupe patrullimi, me qendrat opatore te shoqerise dhe bankes.
11. Sipërmarresi, pajis me numra celulare grupi te gjithe punonjesit e sherbimit te sigurise qe sherbejne ne banke.

12. Sipermarresi, pais me radio manuale komunikimi, te gjithë punonjesit e shërbimit te sigurise ne banke, per te garantuar radionderlidhje me qenden e sigurise ne Tirane dhe qendrat e sigurise ne qarqet ku kryen shërbim.
13. Shoqeria pergatit dhe i dergon Bankes nje raport tre mujor mbi kryerjen e shërbimit te sigurise ne objekte dhe ATM.
14. Shoqeria perpilon dhe i dergon Bankes nje dosje me:
 - Liste e punonjesve te sigurise se jashtme, telefonat e kontaktit
 - Liste e punonjesve te sigurise se brendshme, telefonat e kontaktit
 - Liste e punonjesve te qendres operatore, telefonat e kontaktit
 - Fotokopje e ID personale dhe karte identifikimi te kompanise te punonjesve te sigurise, te parashikuar me siper.
 - Deklarate e punonjesve te sigurise per njohjen e ligjit te funksionimit te SHPSF-ve, - urdherave dhe udhezimeve perkatese per shërbimin e ruajtjes dhe sigurise fizike, - perdorimit te armeve neuroparalizuese, - dhenien e ndihmes se shpejte ne raste zjarri., - rregullores se perbashket te shërbimit ne objekt (pjese e kontrates),
 - Skema e dislokimit te shërbimit ne objekt.

Demshperblim ne rast demi

- 1 Shoqeria do te demshperbleje banken per cdo demtim apo vjedhje te pasurise kur kjo vjen si pasoje e mospëmbushjes se detyrimeve te parashikuara ne kontrate.
- 2 Ne keto raste, shoqeria duhet te te demshperbleje banken brenda 30 ditesh nga data e konstatimit dhe percaktimit te demit. Banka ka te drejte te penalizojë shoqerine per cdo shkelje te pikave kesaj kontrate, pasi ka lajmeruar me shkrim shoqerine per cdo shkelje brenda 3 diteve pune nga konstatimi i saj.
- 3 Banka ruan te drejten te kerkoje demshperblimin e demeve edhe per shkelje per te cilat nuk aplikohet gjobe si dhe nese demet kapërcejne vleren e gjobes.
Me lidhjen e kontrates Shoqeria duhet te dorezoje prane Bankes policen e sigurimit (pergjegjesia profesionale, e dokortësuar paraprakisht me Banken ne akt-marreveshje te vecante) te lidhur me shoqerine/te e sigurimit. Siguracioni duhet te perfshije institucionin e Bankes dhe te jete specifik per aktivitetin qe Shoqeria ofron per shërbimin e sigurise fizike.

Pagesa

1. Banka do te kryejë pagesen, ne numrin e llogarise se shoqerise _____ me banken ProCredit, per shërbimin e kryer ne muajin paraardhes, jo me vone se data 30 e muajit si dhe paraqitja e fatures tatimore. Shoqëria fituese duhet të hap një llogari pranë bankës sonë brenda 48 orëve nga marrja e njoftimit se është shpallur fitues, në rast se nuk ka llogari të hapur pranë bankës sonë.

Kohezgjatja e shërbimit, perfundimi i tyre dhe zgjidhja e kontrates

1. Kjo kontrate hyn ne fuqi ne daten e nenshkrimit nga palet dhe eshte e vlefshme per nje _____ nga data e hyrjes ne fuqi.
2. Palet kane te drejte te zgjidhin kete kontrate duke njoftuar paraprakisht me shkrim palen tjeter te pakten 60 dite perpara.
3. Palet kane te drejte te zgjidhin kontraten me arsyen e duhur ne rastet e meposhtme, kur njera nga palet:
 - a) likuidohet, ose deshton qe te vazhdoje biznesit per arsye te tjera; ose kur ekziston nje rrezik serioz qe pala nuk do te vazhdoje operacionet e saj te biznesit ose do te transferoje operacionet prane nje pale te trete; Ne rastet kur kontraktori transferon operacionet e tij prane nje pale te trete, kjo dispozite do te aplikohet vetem nese ekziston nje rrezik serioz qe pala e trete do te deshtojë ne marrjen persiper dhe vazhdimin e kontrates aktuale ne perputhje me kete kontrate;
 - b) eshte e paafte qe te permbushë detyrimet e saj, eshte regjistruar per falimentim ose ka pëmbushur kushtet paraprake per iniciimin e procedurave per paaftesi paguese, ne vecanti per shkak te borxhit te tepert;
 - c) shkel detyrimet kryesore sipas kontrates dhe nuk i korrigjon keto shkelje brenda 15 diteve pas marrjes se njoftimit me shkrim i cili kerkon ndermarrjen e nje veprimi te tille.

4. Me zgjidhjen e kesaj kontrate, shoqeria merr persiper kthimin e te gjithë dokumentacionit qe i ishte dorezuar per permbushjen e detyrave te tij sipas kesaj kontrate dhe asistimin ne nje dorezim ose riintegrim te rregullt, sic aplikohet ne fushen perkatese te biznesit

Konfidencialiteti, monitorimi dhe raportimet

1. Shoqeria do te mbaje konfidenciale veprimtarine e saj dhe te gjithë dokumentacionin, te dhenat apo informacionet e perfituara nga Banka ne baze dhe per zbatim te kesaj kontrate dhe ne menyre te vecante nuk do te beje ndonje deklarate publike ne lidhje me sherbimet e kryera per Banken, pa miratimin paraprak me shkrese zyrtare te kesaj te fundit.
2. Shoqeria nuk do te nxjerre dhe as te beje te mundur nxjerrjen ose te lejoje personat, te punesuarit ose nenkontraktoret e saj t'u japin personave te trete, apo te perdorin per Shoqerine ose per qellimet e tyre, ndonje informacion ose document te lidhur me Bnaken, pa miratimin paraprak me shkrese zyrtare te kesaj te fundit. Detyrimi per ruajtjen e konfidencialitetit te te dhenave te perfituara ne baze dhe per zbatim te kesaj kontrate, mbetet ne fuqi edhe pas perfundimit te kontrates.”
Gjate ekzekutimit te kesaj kontrate, palet duhet te zbatojne te gjitha nenet qe perfshihen ne Ligjin Nr.9887 “Per mbrojtjen e te dhenave personale”, i ndryshuar.
3. Ne menyre qe te lejohet permbushja e detyrimit per monitorimin e performances se aktivitetit dhe proceseve objekt te kesaj kontrate, palet bien dakord si me poshte:
 - a) Shoqeria pranon te auditohet dhe mbikqyret ne lidhje me objektin e kontrates, nga:
 - (i) Departamenti i Auditit te Brendshem te Bankes;
 - (ii) Auditoret e jashtem te angazhuar nga Banka ne perputhje me rregulloret ligjore.
 - (iii) Entet rregullatore vendase ose çdo subjekt tjetër i autorizuar nga entet rregullatore vendase per kryerjen e nje procesi ekzaminimi.

Autoritete e siperpermendura duhet te kene ne çdo kohe te drejta te plota dhe pakufizuara informimi, rishikimi, auditimi, hyrje duke perfshire te drejten per te bere kopje te çdo dokumenti. Kjo perfshin te drejte hyrje ne te gjitha dokumentet, ne ruajtjen e te dhenave dhe sistemeve te Kontraktorit, ne masen qe ato te merren ne raport me aktivitetet objekt i kontrates aktuale.

 - b) Te gjitha te drejtat e auditimit duhet te qendrojne ne fuqi per nje periudhe te pacaktuar pas mbarimit te kontrates aktuale.
 - c) Kontraktori duhet te ruaje, dhe te jete i afte te siguroje sipas kerkeses, te gjithë dokumentacionin qe i perket sherbimeve te realizuara ne baze te kesaj kontrate per nje periudhe te pacaktuar pas perfundimit te kontrates, e llogaritur nga fundviti i biznesit kur perfundon kontrata.
4. Banka gezon autoritet te plote dhe te pakufizuar per nxjerrjen e udhezimeve, ne çdo kohe, per Shoqerine, ne masen e nevojshme qe kerkohet per permbushjen ne kohe dhe te sakte te aktiviteteve te deleguara kontraktorit sipas kesaj kontrate.
5. Shoqeria ka detyrimin te raportoje ne Banke, ne te gjitha rastet qe ndodhin ngjarje qe mund te vene ne rrezik apo behen pengese per realizimin e sherbimin object kontrate sipas percaktimeve te kontrates. Njoftimi kryhet menjehere ne numrat e kontaktit te bankes dhe me shkrim jo me vone se 24 ore nga ngjarja e ndodhur.
- 6.
7. Shoqeria zbaton masat e sigurise te nevojshme per permbushjen e duhur dhe ne kohe te sherbimeve te percaktuara ne kontraten aktuale. Shoqeria mban dhe ruan te gjitha dokumentet qe i perkasin aktiviteteve te kryera sipas kesaj kontrate per periudha te zakonshme kohore ne perputhje me praktiket tregtare sunduese dhe merr masat e nevojshme parandaluese duke garantuar qe asnje e dhene qe i perket aktiviteteve te realizuara sipas kesaj kontrate te mos humbase.
Per me teper, Shoqeria pajtohet me percaktimet e ligjit mbrojtës se te dhenave ne menyre qe te siguroje mbrojtjen e duhur te te dhenave dhe garanton ruajtjen e konfidencialitetit dhe disponimit te te dhenave dhe qe te dhenat te jene te sakta. Shoqeria merr persiper te siguroje permbushjen e panderprere te sherbimeve te paraqitura ne kontrate, edhe ne rast urgjence.

Zgjidhja e mosmarreshjeve

1. Ne rast se mosmarreshjeje, palet i drejtohen per zgjidhje Gjykates se Rrethit Gjyqesor, Tirane.

Aneksi Nr 5.

Lista e objekteve te Bankes

Nr.	Njesi biznesi	Adresa
1	HO Agency	Agjensia prane HO, Rr. Dritan Hoxha, Laprake
2	Korca	Rr"Midhi Kostani"
3	Durres	"Lagjia nr. 4, Rruga Egnatia Durres, pallatet Xhemf, kulla nr. 3, kati 0"
4	Shkoder	Lagjia Qemal Stafa, Bulevardi Zogu i Parë,
5	Piazza	Rr. Ded Gjo Luli, (pranë Muzeut Kombëtar)
6	Kombinati	Rr. Lambi Bonata 44, (Shkalla 2 Kombinat, Tiranë)
7	Zyra Qendrore	Rr. "Dritan Hoxha", Laprake, Tirane
8	Arkiva	Vore
9	Fier	Rruga Kastriot, hyrja -1

Aneksi Nr 6.

Tabela e detajuar e vleresimit

Kriteret e vleresimit teknik		Menyra e vleresimit	Pesha specifike		Komente mbi vleresimin
1. Eksperienca e përgjithshme e shoqërisë (Vleresimi do të bëhet referuar dokumentacionit të dorëzuar/te kërkuar në Piken B2)			30%		
1.a)	Eksperienca e shoqërisë në treg për 3 vitet e fundit me institucionet financiare	Vleresim në bazë të numrit të kontratave dhe periudhës së bashkëpunimit	100%		Vleresim maksimal do të marrë shoqëria me numrin më të madh të kontratave dhe me afat më të gjatë bashkëpunimi me institucionet financiare.
2. Vleresimi i performancës së shoqërisë (Vleresimi do të bëhet referuar dokumentacionit të dorëzuar/te kërkuar në Piken B2)			30%		
2.a)	Performanca e shoqërisë	Vleresim në bazë të vertetimeve të leshuara nga Drejtorite Vendore të Policisë si dhe referencat e tregut	100%		Vleresim maksimal do të marrë shoqëria që ka performancë pozitive duke i plotësuar të gjitha detyrimet ligjore dhe kërkesat.
3. Kapaciteti i shoqërisë për burimet njerëzore, mjetet në dispozicion dhe infrastrukturën (Vleresimi do të bëhet referuar dokumentacionit të dorëzuar/te kërkuar në Piken B2)			35%		
3.a)	Punonjës shtetërorë të sigurisë (kategoria 1.3 A) në lokacionet ku banka ushtron aktivitetin.	Vleresim në bazë të informacionit të dërguar sipas kërkesës në piken "B2", nenpika 1. (Informacion nga vertetimi i performancës nga DVP dhe lista e shoqërisë)	25%	100%	Vleresim maksimal do të marrë shoqëria që ka numrin më të madh të punonjësve të shtetërorë të sigurisë (kategoria 1.3 A) në lokacionet ku Banka ushtron aktivitetin.
3.b)	Punonjës shtetërorë të patrullës/grupeve të gatshme të vendosura në dispozicion në lokacionet ku Banka ushtron aktivitetin	Vleresim në bazë të informacionit të dërguar sipas kërkesës në piken "B2", nenpika 1. (Informacion nga vertetimi i performancës nga DVP dhe lista e shoqërisë)	25%		Vleresim maksimal do të marrë shoqëria që ka numrin më të madh të punonjësve të shtetërorë të sigurisë patrullë/grup të gatshëm sipas përcaktimeve ligjore (kategoria 1.3 A) në lokacionet ku Banka ushtron aktivitetin.
3.c)	Automjete të vendosura në dispozicion për verifikimin e sinjaleve të alarmit sipas përcaktimeve ligjore	Vleresim në bazë të informacionit të dërguar sipas kërkesës në piken "B2", nenpika 1. (Informacion nga vertetimi i performancës nga DVP dhe lista e shoqërisë).	25%		Vleresim maksimal do të marrë shoqëria që ka në dispozicion më shumë mjete në zonat ku Banka ushtron aktivitetin, sipas përcaktimeve ligjore.
3.d)	Koha e verifikimit të alarmit	Vleresim në bazë të informacionit të dërguar sipas pikës "B2", nenpika 3.	25%		Vleresim maksimal do të marrë shoqëria që ka ofruar kohën optimale dhe të pranueshme të verifikimit të alarmeve
4. Certifikatat e sigurisë: a) UNI — EN — ISO 9001 : për sistemin e menaxhimit të cilësive, b) UNI — EN — ISO 14001 : për sistemin e menaxhimit të mjedisit, c) UNI — EN — ISO 45001 : për sistemin e menaxhimit të sigurisë në punë d) Çertifikatë/a leshuar nga Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK), e) Certifikatë të tjera (Vleresimi do të bëhet referuar dokumentacionit të dorëzuar te kërkuar në Piken "B2", nenpika 1.)			5%		Vleresimi maksimal do të marrin shoqëritë të cilat disponojnë këto dokumenta me subjekt kërkesat e RFO-se.

DEKLARATE MBI GJENDJEN GJYQESORE

E shoqërise pjesemarrëse në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Banka ProCredit sh.a. me objekt _____

Une i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të shoqërise _____ deklaroj se:

- Shoqëria _____ nuk është dënuar për shkelje penale,
- Shoqëria _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prërë, që lidhet me aktivitetin profesional,
- Shoqëria _____ nuk është në proces falimentimi

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Perfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Letra Antikorrupsion (Deklarata e Perputhshmerise)

Grupi ProCredit vlereson se ndikimet etike, shoqerore dhe mjedisore jane pjese e rrjetit te furnizimit. Veç kesaj, ndikimet pozitive mund te arrihen permes blerjes se produkteve dhe/ose sherbimeve me te pergjegjshme, si dhe duke punuar bashkerisht me furnitorët për të ndikuar pozitivisht në performancën etike, shoqerore dhe mjedisore. Ndaj, Grupi ProCredit pret prej furnitoreve/kontraktoreve të tij që t'i përmbahen një pakete standardesh minimale për të garantuar pajtueshmërinë e angazhimeve të tyre për çështjet kryesore shoqerore, mjedisore dhe të administrimit me standardet e larta të ProCredit.

Njesoj siç veprohet me klientet, Grupi ProCredit pret prej furnitoreve dhe kontraktoreve të tij që të mos angazhohen në asnjë prej veprimtarive të renditura në Listen e Perjashtimit të ProCredit. Aktivitetet me të rendesishme, por jo të vetmet, që përmban kjo liste janë:

-Prodhimi ose veprimtarite që përfshijnë forma të demshme ose shfrytëzuese të punës së detyruar/punës së demshme për fëmijet, praktikë diskriminuese ose praktikë që i pengojnë punonjësit të ushtrojnë në mënyrë të ligjshme të drejtat e tyre të lirise së organizimit dhe të negocimit kolektiv (për hollësi të metejshme, shihni piken a) të Listës së Perjashtimit)

-Respektimi i ligjeve dhe rregulloreve kombëtare, si dhe konventave dhe marrëveshjeve ndërkombëtare për prodhimin dhe/ose tregtimin e çdo produkti apo veprimtarie (për hollësi të metejshme, shihni piken e) të Listës së Perjashtimit)

-Shoqëria konfirmon se nuk kryen aktivitete tregtare të gjendura në listen përjashtimore të ProCredit Grup.

-Duke qenë se Grupi ProCredit i përmbahet Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (1948) pret që të njëjten gjë të bëjnë edhe furnitorët dhe kontraktorët e tij. Kështu, shoqëria tregtare konfirmon se iu përmbahet standarteve dhe etikës me të lartë të biznesit gjatë procesit të tenderit dhe gjatë zbatimit të kontratës. Ajo zbaton standartet e Shendetit, Sigurisë në punë, Sigurisë Mjedisore dhe standartet e ILO dhe nuk është e përfshirë në punën e detyruar ose në punën e paligjshme të fëmijëve. Gjithashtu shoqëria konfirmon se nuk është e përfshirë në praktikë diskriminuese apo praktikë që ndalojnë punëmarresit e saj për të ushtruar të drejtën e tyre ligjore për t'u mbledhur dhe anëtarësuar në organizatat e punëmarresve.

-Shoqëria pranon se përfshirja e saj në një nga praktikët e paligjshme të përmendura më sipër, do të sjellë përjashtimin e saj nga procedura e tenderimit ose ndërprerjen e kontratës në mënyrë të menjehershme nga ana e ProCredit Bank sha.

- Siç përcaktohet në Kodin e Sjelljes, Grupi ProCredit nuk toleron rastet e pastrimit të parave, mitmarrjes dhe korrupsionit. Prandaj, marrëdhëniet e biznesit nuk mund të krijohen ose të vazhdojnë në rast se mesohet që një furnitor potencial është i përfshirë në rastet e pastrimit të parave, korrupsionit dhe/ose mashtrimit. Thëksohet se Grupi ProCredit nuk pranon rryshfete të asnjë forme dhe as nuk pranon angazhimin e furnitoreve në praktikë të tilla.

Furnitorët dhe kontraktorët që rezultojnë të përfshirë në veprimtari të kësaj natyre, do të përjashtohen nga mundësia për t'u bërë partnerë.

-ProCredit Bank do të refuzojë ofertat pjesëmarrëse në tender, nëse deshmohet ose nëse konsiderohet se shoqëria është e përfshirë në ndonjë rast të pastrimit të parave, mashtrimit ose në rastet e korrupsionit gjatë procesit të tenderit ose do të anulohet kontrata nëse deshmohet se ka ndodhur ndonjë nga keto raste gjatë procesit të dhenies së kontratës.

-Për qëllimet e kësaj politike aktivitete të mëposhtme do të konsiderohen si korrupsion:

- a) *Veprimin e të dhenit, pranuarit ose kerkimit të mjeteve të çfaredo vlere, për të ndikuar të ndonjë person tjetër juridik, personel të PCB-se ose të ndonjë shoqëri tjetër, gjatë procesit të tenderimit ose gjatë dhenies së kontratës.*
- b) *Dëmtimin e pronës së PCB-se, kercenimin e personelit të PCB-se, kercenimin për dëmtim të reputacionit të PCB-se ose ndonjë shoqërie tjetër për të ndikuar në procesin e tenderimit ose për zbatimin e kontratës së dhënë.*
- c) *Marrëveshjen në mes të dy ose më shumë shoqërive për të imponuar ose për të ndikuar në tenderet e papershtatshëm, tendere me çmime artificiale ose çmime jo konkurruese.*

d) Falsifikimin e qellimshem, ndryshimin, fshehjen ose paraqitjen e gabuar te informatave te kerkuara ose te paraqitura gjate procesit te tenderit ose gjate zbatimit te kontrates.

-Per qellimet e kesaj politike veprime te mashtimit konsiderohen perpjekjet ose pakujdesite e qellimshme per te mashtruar ose perpjekjet per te mashtruar stafin e PCB-se ose shoqerive te tjera, ne menyre indirekte ose te drejtperdrejte, per te perfituar financiarisht ose per t'ju shmangur detyrimeve te percaktuara me kontrate ose me ligj.

Grupi ProCredit pret prej furnitoreve te tij te angazhohen dhe te respektojne ndershmerisht standardet e percaktuara ne kete dokument. Furnitoret priten te demonstrojne angazhimin e tyre duke bashkepunuar ngushtesisht me Grupin ProCredit, si dhe duke ofruar akses te arsyeshem ne dokumentacionin/informacionin perkates, nese gjykohet e nevojshme. Ne rastin e shkeljeve te renda dhe/ose te vazhdueshme te standardeve te percaktuara ne kete dokument, Grupi ProCredit do te ndermarre hapat e nevojshem per nderprerjen e marredhenieve te biznesit.

Me nenshkrimin e ketij dokumenti, nenshkruesit konfirmojne autoritetin e tyre per te nenshkruar ne emer te furnitorit dhe per t'u angazhuar per respektimin e standardeve te percaktuara ne te.

Deklarata per t'u nenshkruar nga furnitori/kontraktori

Emri i kompanise _____

Numri i regjistrimit _____

Numri i kontrates/tenderit _____

Adresa _____

Data _____

Nenshkrimi i autorizuar _____

Emri _____

Titulli _____

Pyetësi i ILO-s për përputhshmërinë e furnitoreve

1. Informacione të përgjithshme

Emri i kompanisë	
Produktet kryesore dhe sektori	
Shteti/shtetet e prodhimit/operimit	
A i eksportoni/ofroni produktet/shërbimet tuaja në vendet e BE-së?	

2. Shëndeti dhe siguria profesionale

A ka vendosur dhe a zbaton kompania juaj procedurë për shëndetin dhe sigurinë profesionale në përputhje me praktikën e mirë ndërkombëtare të industrisë për të parandaluar aksidentet, dëmtimet dhe sëmundjet? A mund të rendisni disa nga udhëzimet/standartet dhe procedurat përkatëse? Sa shpesh rishikohen apo monitorohen ato?	
A ka kualifikime/trajnime specifike që duhet të kete stafi juaj për të kryer detyra të caktuara? Si i ndiqni nevojat për trajnim? Një herë në sa kohë zhvillohen trajnime?	
Si e ndiqni dhe si e raportoni shkallën e dëmtimeve, sëmundjeve profesionale, ditët e mungesave, fenomenin e të munguarit në punë dhe numrin e viktimave që lidhet me punën?	
Si i parandaloni zjarret dhe çfarë do të bënit ju dhe stafi juaj në rast emergjence për shkak të një zjarri?	
Nëse pyetja vlen për kompaninë në fjalë: A e pajisni stafin me pajisje mbrojtëse? Nëse po, çfarë pajisjesh?	

3. Barazia në mundësi dhe në trajtim

Si e ndiqni diversitetin në kompaninë tuaj?	
Si e parandaloni diskriminimin në kontekstin e rekrutimit, shpërblyerjes dhe ngritjes në detyrë? A keni mekanizma për shqyrtimin e ankesave?	
A aplikoni mekanizma/politika/programe specifike për të inkurajuar gratë apo grupet e tjera të vulnerabël? Për shembull, këtu mund të përfshihen targetet lidhur me raportin specifik femra-meshkuj, programe mentorimi të projektuara specifikisht, si dhe koncepte specifike për komunikimin me grupet të vulnerabël.	

a. Dokumentacion i shkurtër

Ju lutemi, ndihuni të lirë t'i bashkëngjithni përgjigjet tuaja për pyetjet e mësipërme dokumentet përkatëse (pra, procedura, udhëzime, politika dhe standarde, nëse dëshironi).

b. Konfirmimi

Data dhe vendi

Emri i plote dhe pozicioni

Firma

Me nenshkrimin e ketij dokumenti, nenshkruesit konfirmojne se kane autoritetin te nenshkruajne ne emer te kompanise dhe te japin pergjigje plotesisht te verteta.

FORMULAR OFERTE

[Ofertuesi duhet te plotesoje kete Formular ne perputhje me udhezimet e treguara. Nuk lejohen ndryshime apo zevendesim te ketij formati.]

Date: ____/____/____

[plotesoni daten (dite, muaj, vit) e dorezimit te ofertes]

Numri i fteses :.....:

Per: **ProCredit Bank**
Departamenti Finances
Tirane, Shqiperi

Ne, te nenshkruarit, deklarojme qe:

- (a) Ne kemi shqyrtuar dokumentacionin e paraqitur ne kete procedure prokurimi dhe pranojme, pa rezerva ose perjashtime, kerketat, afatet dhe kushtet e shprehura ne to;
- (b) Ne sigurojme furnizimin ne perputhje me Dokumentat e Tenderit, Afatet e Levrimet per Mallrat dhe Sherbimet respektive si me poshte _____ [plotesoni shkurtimisht mallrat, apo sherbimet respektive];
- (c) Ne permbushim gjithë kerketat ligjore, financiare-ekonomike dhe teknike te specifikuara ne dokumentat e tenderit si vertetohet nga certifikatat dhe dokumentat e dorezuara me kete deklarate.
- (d) Cmimi total i Ofertes sone, perfshire cdo detyrim tatimor eshte: _____ [plotesoni cmimin total te ofertes me numra dhe fjale, si dhe monedhen];
- (e) Oferta jone do te jete e vlefshme nga data e dorezimit te ofertes deri me date.....;
- (f) Nese oferta jone do te pranohet, ne angazhohemi te mbajme nje garanci kontrate ne perputhje me dokumentat e tenderit nese kjo eshte e aplikueshme;
- (g) Ne nuk kemi konflikt interesi ne perputhje me Letren Antikorrupsion;
- (k) Ne kuptojme se kjo oferte, sebashku me njoftimin tuaj zyrtar te shpalljes se fituesit do te sherbeje si nje kontrate e perkohshme ndermjet nesh, derisa te pergatitet dhe nenshkruhet kontrata zyrtare.
- (l) Ne kuptojme qe nuk jeni te detyruar te pranoni oferten me cmimin me te ulet ose cdo oferte tjeter qe ju mund te mermi.

Firmosur: _____

Date: _____